Ferizaj/17 vjeçari mbante armë zjarri, Policia i shkojnë në shpi dhe ia konfiskojnë

11:23 | 28 Janar 2022

Policia e Kosovës ka konfiskuar një armë zjarri në shtëpinë e një 17 vjeçari.

Krejt kjo, sipas Policisë së Kosovës, rajoni i Ferizajt ka ardhur falë informatave inteligjente, shkruan arbresh.info.

“Stacioni policor në Han të Elezit nga Drejtoria Rajonale e Policisë në Ferizaj ka pranuar një informacion inteligjent se, një person me inicialet A.SH (M/K) i moshës 17 vjeçar posedon armë zjarri. Në lidhje me këtë policia në bazë të autorizimeve dhe në konsultim me Prokurorin e Prokurorisë Themelore në Ferizaj, ka marr veprimet e nevojshme dhe ka gjetur në shtëpinë e tij një armë zjarri automatike me një karikator pa fishek”, njofton policia.

Me vendim të Prokurorit të Prokurorisë Themelore në Ferizaj, ndaj të dyshuarit A.SH është inicuar rasti penal ” Mbajtje në pronësi, kontroll ose posedim i paautorizuar i armëve” për procedurë të rregullt hetimore, ndërsa arma i është konfiskuar./arbresh.info/

Shpërndaje në rrjete sociale

17 VJEÇARI ARME FERIZAJ KONFIKIM POLICIA

Lajmet më të lexuara

Të ngjashme

Ferizaj/17 vjeçari mbante armë zjarri, Policia i shkojnë në shpi dhe ia konfiskojnë

11:23 | 28 January 2022

Mbi 9,000 raste aktive me COVID-19 në Prishtinë

10:50 |

Prokuroria kërkon paraburgim për zyrtarin e Autoritetit Pyjor të Komunës së Prizrenit, Ize...

10:46 |

Foto lajm

Mehaj priti kryetarin e federatës “Vatra”, biznesmenin nga Kosova dhe lobuesin e çështjes kombëtare në SHBA, Elmi Berisha

20:06 | 27 Janar 2022

© Arbresh.info 2015-2019
Të gjitha të drejtat janë të rezervuara.